



KONTRATË PËR BLERJE AKSIONESH

Sot më datën 05.02.2003 (dy mijë e tre), në Dhomën e Noterisë Tiranë para meje Noteres Publike Eriketa Kokoli, ndërmjet:

- a) **Vassilios FOURLIS**, i biri i Stylianout dhe i Thalias, afarist, lindur në SHBA në vitin 1960, banues në Kifisia Attikis, Rr. Pileos nr.26, mbajtës i Letërnjoftimit Nr. S.700173/15.01.1999 lëshuar nga Komisarjati i Policisë së Kifisias dhe me Kodin Fiskal Nr. 030509257 të Degës së Tatim Taksave të Kifisias, përfaqësuar në këtë kontratë nga z. Andon Kokoli, mbajtës i pasaportës shqiptare Nr.0865688, në bazë të Prokurës Nr. 4.663/13.01.2003 të redaktuar nga Noteri Publik z. Stefanos K. Vasilakis me seli në Pire, Rr. Kolokotroni nr.70 (në vazhdim e quajtur "**Shitësi**").
- b) **Shoqërisë Anonime "PIRAEUS BANK" S.A**, shoqëri e organizuar dhe që vepron sipas ligjeve greke, me seli në Athinë (20 Amalias Avenue & 5, Souri Str.), regjistruar rregullisht në Regjistrin e Shoqërive Aksionere mbajtur nga Ministria e Tregtisë me Nr.6065/06/B/86/04 përfaqësuar ligjërisht në këtë kontratë nga z. Dimitrios Karavias, shtetas grek, mbajtës i pasaportës greke Nr. M 145813/04.04.1996, në bazë të Prokurës Nr.4.675/17.01.2003 redaktuar nga Noteri Publik z. Stefanos K. Vasilakis me seli në Pire, Rr. Kolokotroni nr.70 (në vazhdim i quajtur "**Blerësi**").

Është rënë dakort sa më poshtë vijon:

- 1. Shitësi** ka të drejtën e plotë dhe ekskluzive të pronësisë e posedimit të një mijë e pesëqind e njëzet e katër (1.524) aksioneve të regjistruara me një vlerë nominale prej një qind (100) USD secili. Këto aksione përfaqësojnë 2% të kapitalit aksioner të shoqërisë anonime BANKA e TIRANËS, shoqëri që është themeluar dhe që vepron sipas legjislacionit shqiptar, në bazë të Liçensës së Veprimit Nr. 07/12.09.1996 lëshuar nga Banka e Shqipërisë. Për këto aksione është lëshuar një certifikatë aksioni provizore (Nr.14 datë 27.04.2000).
- 2. Shitësi** i shtet, transferon e dorëzon pronësinë dhe posedimin e plotë të të gjitha aksioneve të sipërpërmendura, dhe më saktë të një mijë e pesëqind e njëzet e katër (1.524) aksioneve të regjistruara me një vlerë nominale prej një qind (100) USD secili, që përfaqësojnë 2% të kapitalit aksioner të shoqërisë anonime BANKA e TIRANËS, me të gjitha të drejtat që rrjedhin prej tyre, **Blerësit** i cili e pranon këtë blerje kundrejt çmimit të vlerës totale prej dyqind e tetëdhjetë e tre mijë (283.000) EURO. Palët kontraktuese do të proçedojnë njëkohësisht në regjistrimin e duhur të



këtij transaksioni si në Librin e Aksioneve, ashtu dhe në Librin e Aksionerëve të BANKËS së TIRANËS.

- 3. Blerësi** i ka paguar plotësisht **Shitësit** çmimin prej dyqind e tetëdhjetë e tre mijë (283.000) EURO.
- 4. Shitësi** deklaron se aksionet transferohen të lira dhe të pastra nga çdo peng, barrë ose detyrim tjetër ligjor, ose ndonjë difekt aktual ose ligjor në përgjithësi.
- 5.** Palët bien dakort që **Shitësi** nuk ka asnjë të drejtë tjetër ndaj **Blerësit** në lidhje me blerjen e këtyre aksioneve.
- 6.** Pas transferimit të aksioneve, **Shitësi** nuk ka asnjë të drejtë ose titull mbi këto aksione dhe **Blerësi** të cilit i janë transferuar dhe dorëzuar aksionet në kushtet e pronësisë dhe posedimit të plotë, ka të drejtë t'i zotërojë, posedojë, përdorë, shfrytëzojë dhe rregullojë ato sipas vullnetit të tij të lirë si pronar dhe posedues i tyre. **Blerësi** ka të drejtë të ushtrojë të tëra të drejtat që rrjedhin nga e drejta e tij e pronësisë dhe ai do të marrë nga BANKA e TIRANËS certifikatat përfundimtare të aksioneve kur ato të lëshohen.
- 7.** Çdo mosmarrëveshje që do të lindë në lidhje me ekzekutimin ose interpretimin e kësaj kontrate do të shqyrtohet nga Gjykata kompetente e Tiranës.
- 8.** Palët kontraktuese deklarojnë se heqin dorë nga e drejta për ta apeluar dhe për ta revokuar (shfuqizuar) këtë kontratë.

Në dëshmi të sa më sipër, kjo kontratë ekzekutohet në katër origjinale, nga të cilat nga një kopje u jepet palëve, kopja e tretë mbahet nga Noteri Publik e kopja e katërt depozitohet në Regjistrin Tregtar, dhe konform vullnetit të lirë të palëve, të cilët pasi e lexuan e me zë të lartë në prezencë të përkthyeses Violeta XHAMO lindur më 01.10.1969, lindur e banuese në Tiranë me pasaportë Nr.0063577 dhe pasi u kuptua nga Palët u nënshkrua rregullisht prej tyre para Noterit.

PALËT KONTRAKTUESE

SHITËSI

“DATAMEDIA” S.A.

Përfaqësuar me Prokurë nga

Përkthyesë:

Violeta Xhamo

BLERËSI

“PIRAEUS BANK” S.A.

Përfaqësuar me Prokurë nga

D. KARAVI

NOTERI
NOTERE
ERIKETA KOKOLI